

Drejtoresha e Arsimit në Kuvendin Komunal të Prishtinës, Arbrie Nagavci, në profilin e saj në Facebook ka shkruar se vetëm në Komunën e Prishtinës janë mbi 810 nxënës (të ciklit fillor e të mesëm) që janë larguar nga bankat shkolle shkollë muajt e fundit.

*“Vetëm në Komunën e Prishtinës mbi 810 nxënës janë larguar nga bankat shkolle muajt e fundit.*

*Alarmante!*

*Dhe, kolegu im nga një Komunë që qeveriset nga LDK, bën fajtor për largim të popullsisë opozitën, protestën, grevën e mësimdhënësve.*

*Jo rastësisht jemi në këtë situatë PDK&LDK&Srpska - kombinim fatal.*

*Po e prekim fundin”, ka shkruar ajo.*